



## Eparki e Horës së Arbëreshëvet

### Lajm i Krishtëlindjes 2017

*Shi se pritja e gjindevet buron nga Virgjëra:  
Betllemi me lumturi hap Edenin që kish klënë mbëllijtur,  
tue mirëpritur Fjalën e mishëruame vënë te një grazhdë.  
(Theotokion, e diela e Stërgjyshërvet)*

Vëllezër dhe Motra të dashur,

Në t'u qasurit të Të Shejtes Lindje-Theofani të T'YnZoti i lejoj vetes të ju drejtojë lajmin tim vëllazëror dhe të përzemërt. Ai është shprehje e sinqertë t'asaj dashurie baritore që buron nga bashkëpranimi i jetës së besës dhe, që në ndodhje si këto, bëhet fjalë që jep zëmbër dhe shprese.

Zotimi i Klishës dhe mundimi i gjithë burravet dhe të gjithë gravet me vullim të mirë **të krijohet te territori yn një kulturë alternative** t'asaj gjerësisht të shpërhapur, kanë në ngjarjen e Krishtëlindjes-Theofani themelin më e fortë dhe motivimi më i ngutshëm.

Kremtimi i ditëlindjes dhe të ujët të bekuam na nget, te rrenjët më e thella të dashamirësisë tënë dhe, te konteksti kulturor në të cilin rrojmë, na rithërret **të jemi ndërtues të njëi historie që nxiton njeriun i vërtetë.**

Nëse te tradita e krishterë kremtimi i Krishtëlindjes-Theofani u bë festa e thellësisë familjare dhe të vëllazërisë së popujvet, arsyeja rri te fakti se kjo festë është më parë se gjithë rivelacion, zbulesë e plotë të historisë së Perëndisë që ndrit, ndih dhe prin historinë e njerëzvet.

E Shejta Lindje-Theofani na zbulon se Perëndia, kujt i kemi besim, ngë është një vetë që vëren nga llargu vuajtjet dramatike – dhe her'e herë tragjike të ngjarjes së një njerëzore – por **një Perëndi që na dhurohet neve**, hyn te jeta jonë, jo për të ecur përkrahu historisë së një por **për t'u bërë bashkë me ne** – në një marrëlidhje aleance të ëndshme dhe të pashprehshme – **krijues të njëi kulture të re.** Ajo ngë do të duhet të jetë karakterizuar nga ato forma të shumëfishta të egoizmit njerëzor që na i njohim dhe nga të cilat vuajmë, por zotëruar përkundra nga të panumërtat shprehje vëllazërie dhe paqeje që dashuria e Perëndisë, e mishëruame te njeriu, është në gjëndje të ngjallë dhe të zhvillojë.

Ju bëj thërritje prandaj, të *e rroni këtë qëro liturgjik*, jo si një festë që ngjall episodike dhe të përcipta ndjenja mirësie, por *si kremtimi i hareshëm të pritjes së njëi Dhurate që bëhet brumë të ngrydhur të njëi detyrimi të thellë dhe që nduris për të ndërtuar te njësia paqen e vërtetë.*

Kremtimi i hareshëm të pritjes së dhuratës së Krishtëlindjes-Theofani kihet kur jeta jonë hapet Perëndisë dhe i lejohet Perëndisë të banojë te qendra e ekzistencës sënë për t'e ndritë atë me dritën e të Vërtetës së Tij dhe me fuqin e Dashurisë së Tij.

Vetëm në rastin që i lejojmë Perëndisë të mishërohet te historia jonë, bëhemi ata që nxitojnë një kulturë që merr pjesë dashurisë së Perëndisë dhe ndryshon territorin tënë nga një xungël ku ndodhen burra dhe gra të egër te një kopsht i banuar nga veta që rrojnë dhe veprojnë vërtet te kthjelltësia, te harmonia dhe në paqe.

Në mbarim mendoj se është më e larta rëndësi të kujtohet nga gjithë, burra dhe gra, si të pagëzuam, se *njësia është i pari misioni yn*. Detyra e Ipeshkpit përmbahet te porosia e të siguruar lidhjen me traditën apostolike dhe me bashkësinë e gjithë Klishëvet rreth pasardhësit të Pietrit te selia romake. Puna e kësaj detyre mënd të thuhet e bërë në mënyrë të përshtatshme kur zbatohet njësia e besës dhe bashkësia e jetës brënda komunitetit eparkial/dioqezan rreth atij te mundimi të qellet, të sillet Vangjelin gjithasajtën tue u ngalkuar – me lajmin dhe me dashurinë – për sa janë ata që bashkëpranojnë përvojën e jetës te territori.

Festa e Të Shejtes Lindje-Theofani të T'YnZoti, që ngë mënon, na shtyn edhe më shumë ndaj ndjenjash gëzimi të vërtetë për dhuratën dashurie të të MadhitZot dhe ndaj qëndrimesh vëllazërie të sinqertë për praninë e Tij në mes nesh. I uroi këto nganjerit dhe nganjerës jush, shumë të dashur vëllezër dhe motra, për të mirën e Klishës tënë që është në Horën e Arbëreshëvet dhe të atyre që kanë kujdes për shërbimin e saj apostolik.

Hora e Arbëreshëvet, dhjetor 2017

✠ Gjergj Dimitër, Ipeshkëp

